



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E OBILIQIT - OPŠTINA OBILIC
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE



Dalës-Izleznë

Nr. -1-86/1
Br.

Data 30.06.2023
Datum

OBILIQ

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIC - MUNICIPALITY OF OBILIC



KUVENDI KOMUNAL OBILIQ

Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

Në mbështetje të nenit 12.2, pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare nr.28 të dt.04.06.2008), bazuar në Ligjin nr.04/L-174 Për Planifikimin Hapësinor si dhe aktet administrative në fuqi, sipas Planit Zhvillimor Komunal me nr-I-72 të dt.02.06.2023, (PZHK- 2023-2031 fq.289, harta nr.2-Harta e Shfrytëzimit të Planifikuar të Tokës) nenit 44.1 dhe 47.3, të Statutit të Komunës, si dhe nenit 39 të Rregullores së punës së Kuvendit, pas shqyrtimit të kërkesës nga Reis Sallova, nga komuniteti i Lagjes "Washingtoni" nr. -I-9584/23, e dt.07.04.2023, pas sqarimit të Drejtorit të DPUPK-së me nr. V-690, të dt. 27.06.2023 si dhe pas shqyrtimit të kërkesës për vlersimin e ligjshmërisë nga MMPHI-ja, me nr.3113-2/23 e dt.14.06.2023, Kuvendi komunal në mbledhjen e mbajtur me dt. 30.06.2023, mori këtë:

V E N D I M

1. Bëhet plotësimi dhe ndryshimi i Vendimit nr.I-67 të dt.31.05.2023, për caktimin e lokacionit të ri për ri vendosjen e Tregut në Njësinë Kadastrale nr.P-72614055-01885-0, me sipërfaqe prej 5801 m² e cila evidentohet në emër të Komunës së Obiliqit, e cila në anën veri lindore ka qasje në rr: "Mentor Dervishaj" ndërsa në anën veri perëndimore ka qasje në rr: "30 Marsi".
2. Zhvendosja e Tregut bëhet nga lokacioni aktual në lokacionin e ri me qëllim që banorët të kenë qasje në rr: "Washingtoni".
3. Meqë, "Infrakosi" është duke bërë revitalizimin e Hekurudhës, e cila atakon Komunën tonë, në këtë pjesë përballë Tregut ekzistues planifikohet ndërtimi i një nënkalimi, i cili iu mundëson qasje në rr: "Washingtoni" qytetarëve të cilët banojnë në anën tjetër të hekurudhës.
4. Investitori i objekteve banesore do të bartë të gjitha shpenzimet e lirimit të parcelës ekzistuese (Tregut dhe një objekti të pashfrytëzueshëm që gjendet afër Tregut) dhe po ashtu do të bartë të gjitha shpenzimet për vendosjen e Tregut në lokacionin e ri të caktuar nga Kuvendi Komunal brenda për brenda dimensioneve ekzistuese.
5. Ky Vendim hyn në fuqi (15) pesëmbëdhjetë ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokolit të MAPL-së, dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në web faqen e Komunës.

T'i dërgohet

- Kryetarit
- Nënkryetarit
- Kryesueses
- Anëtarëve të KK
- Anëtarëve të Komisionit
- MAPL
- Arkivit

Kryesuese e Kuvendit Komunal
Vlora Mjekiqi Kabashi
Vlora Mjekiqi Kabashi